



QENDRA E
INOVACIONIT TË
SIGURISË DHE
MBROJTJES



13 -19 TETOR
JAVA E MBROJTJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

IM
TURIST
PROAKTIV
TIFICIALE

ZHVILLIM TEKNOLOGJIK
PIONER
BASHKËPUNIM
STRATEGJITURIST
RISI
STRATEGJITURIST
MODERNIZIM

INOVACION KËRKIM DHE ZHVILLIM
STRATEGJITURIST
EKSPLORUES
FAB LAB
MODERN
IDEATOR
AVANTGARDË
TEKNOLOGJITURIST

MINISTRI VENUGU NË QENDRËN E INOVACIONIT TË SIGURISË

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu zhvilloi një takim në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ku u diskutua rreth hapave të mëtejshëm në strategjisë kombëtare “Mbrojtja 2030”. Në takim u theksua rëndësia e implementimit të Inteligjencës Artificiale, si instrument kyç për sintetizimin e informacionit si dhe zhvillimi teknologjik i Forcave të Armatosura në nivel kapilar.

★★★★★

mod.gov.al

JM



MINISTERIALI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-S

Zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, që u zhvillua në Bruksel. Në fjalën e saj, znj. Abrazhda u ndal në përpjekjet e Shqipërisë për avancimin e prioritetëve të mbrojtjes, në përputhje me vendimet e Samitit të Hagës.

JM





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

GODINA E RE E QENDRËS SË PERSONELIT TË REKRUTIMIT

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, vizitoi godinën e rindërtuar të Qendrës së Personelit të Rekrutimit (QPR), e cila, tashmë, ofron kushte moderne dhe funksionale për zhvillimin e aktivitetit të përditshëm. Punimet e realizuara në më pak se një vit, kanë përfshirë një sipërfaqe prej 3.700 metrash katrorë dhe kanë sjellë përmirësime të thelluara në të gjitha ambientet.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES


URË E RE NË FSHATIN PAPER SALLAK

Në fshatin Paper Sallak, Bashkia Elbasan u finalizua ndërtimi i urës së re. Me gjatësi 12 metra dhe kapacitet mbajtës deri në 24 ton, ura do të lehtësojë lëvizjen e rreth 600 banorëve të zonës dhe do të përmirësojë aksesin drejt shkollave dhe qendrave shëndetësore, duke sjellë një ndihmë të rëndësishme për komunitetin lokal.

JM

★★★★★

mod.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



PËRFUNDON KURSI “DHËNIA E NDIHMËS SË PARË”

13 efektivë të Komandës Mbështetëse dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura, përfunduan kursin funksional “Dhënia e ndihmës së Parë”. Përmes programeve mësimore të përditësuara, kursantët morën njohuri për mënyrat, teknikat e përdorura për dhënien e ndihmës së parë, duke filluar nga momenti i ndodhjes së ngjarjes e deri në transportimin e sigurt të lënduarit në institucionin mjekësor.

★★★★★

mod.gov.al

JM



SHQIPËRIA NË DREJTIM TË SESIONIT TË VJESHTËS SË NSPA PËR RWA

Zëvendës Komandanti i Forcës Ajrore, Kolonel Luan Sadiku, në cilësinë e drejtuesit (Chairperson), drejtoi sesionin e 45-të të Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) për Komitetin e Avionëve me Krahë të Rrotullueshëm (RËA), zhvilluar në Luksemburg më 13-14 tetor 2025. Gjatë vitit 2025, Shqipëria mban kryesimin e këtij komiteti, duke forcuar rolin e saj në fushën e mirëmbajtjes dhe mbështetjes së helikopterëve të Forcës Ajrore në kuadër të NATO-s.

★★★★★



BIG BAND – OSFA KONCERT NË AMFITEATRIN “MIRUSH KABASHI”

Në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë, Big Band – OSFA ka zhvilluar një koncert të hapur për publikun në Amfiteatrin “Mirush Kabashi”. Në koncert kanë qenë të ftuar Eneda Tarifa, Lambert Jorganxhi dhe Iris Sula, të cilët kanë performuar përkrah orkestrës, duke krijuar një atmosferë festive për qytetarët e Tiranës.

JM

★★★★★